



## Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

# Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve

Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve (BPRI) është një projekt rajonal për Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i tij është që të kontribuojë në integrimin e romëve në rajon, duke reflektuar mbi përkushtimet që janë bërë si shtete anëtare të OSBE-së si dhe me synimin e mundshëm për t'iu bashkuar BE-së.

Si pjesë e Planit të Veprimit të OSBE-së hartuar në vitin 2003 mbi Romët dhe Sintët, Dekadës së Përfshirjes së Romëve dhe strategjive kombëtare për integrimin e romëve, qeveritë, organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile Rome në Ballkanin Perëndimor janë duke punuar së bashku në promovimin e përfshirjes sociale të romëve dhe luftën kundër diskriminimit me të cilin ata përballen.

Drejtorja e Përgjithshme e Zgjerimit të BE-së ka mbajtur një numër konferencash të nivelit të lartë për Romët duke përfshirë të gjitha qeveritë në rajon, nga të cilat kanë dalë një seri përfundimesh dhe angazhimesh. Që romët të jenë me të vërtetë përfutues, qeveritë duhet të rrisin përpjekjet e tyre dhe të gjejnë zgjidhje të reja. Organizatat e shoqërisë civile, dhe sidomos OJF-të Rome, do të duhet të vazhdojnë advokimin për reformat, duke propozuar zgjidhje më përfshirëse si dhe duke ngritur vetëdijen në lidhje me statusin e Romëve.

Projekti BPRI do të mbështesë këtë proces duke promovuar programe të reja dhe duke mundësuar bashkëpunimin midis qeverive lokale dhe qendrore, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile.

## Detajet e Projektit:

**Ku:**  
Ballkani Perëndimor

**Juridiksionet e synuara:**  
Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova\*, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

**Zbatuar nga:**  
Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), në bashkëpunim me zyrat rajonale të OSBE-së.

**Kur:**  
Janar 2012 – Nëntor 2013

**Buxheti:**  
3.3 milion EURO  
Financimi i dhënë nga:  
Bashkimi Evropian (90 për qind)  
Shtetet anëtare të OSBE-së (10 përqind)

*"Ky projekt është jetik për të ndihmuar administratat dhe shoqërinë civile në rajon në luftën e tyre kundër diskriminimit dhe për të promovuar shanse të barabarta për romët, duke bërë të mundur që komunitetet e romëve, përfaqësuesit e tyre dhe shoqëria civile të marrin të drejtën e pronësisë mbi programet e plota dhe të qëndrueshme për të përmirësuar gjendjen e tyre."*

Ambasadori Janez Lenarčič  
Drejtor i OSBE-së për Zyrën për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

\* Ky përcaktim është pa paragjykim për pozicionet rreth statusit, dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/99 dhe opinionin e ICJ mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.





## Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

### Projekti BPRI ka pesë komponentë kryesorë:

#### 1. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike dhe vendim-marrja

Projekti do të identifikojë nevojat dhe burimet për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planet e veprimit, dhe do të përqendrohet në pjesëmarrjen lokale të Romëve. Praktikrat e mira të përzgjedhura do të përdoren për të përgatitur një protokoll të përbashkët për të ndihmuar në përcaktimin e vetë-qeverisjes lokale dhe zbatimin e iniciativave që inkurajojnë pjesëmarrjen e Romëve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së grave rome dhe motivimit të tyre në fushatën për të drejtat dhe interesat e tyre.

#### 2. Dhënia e ndihmës ligjore

Do të paraqiten praktikrat më të mira për regjistrimin civil të komunitetit rom – sidomos të zhvendosurve, refugjatëve dhe migrantëve – dhe këto do të diskutohen me autoritetet përkatëse, ligjvënësit dhe ekspertët. Projekti do të nxjerri në pah politik at dhe metodat praktike në kontekstet rajonale që adresojnë pengesat administrative dhe financiare për regjistrimin.

Njëkohësisht, projekti do të hartojë dhe do të kryejë fushata informuese për romët në lidhje me procedurat e regjistrimit dhe do t'i inkurajojë ata të aplikojnë për dokumente personale. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me shoqërinë civile Rome.

Na kontaktoni në:

ul. Miodowa 10, 00-251 Warsaw, Poland

Tel: +48 22 520 06 00

Fax: +48 22 520 06 05

bpri@odih.pl

#### 3. Legalizimi i banesave dhe vendbanimeve

Projekti do të advokojë për legalizimin e vendbanimeve Rome përmes shpërndarjes së informacionit për standardet e aplikueshme, rregulloret ligjore dhe administrative, hapave të nevojshëm dhe shembujve të praktikave më të mira. Për të arritur këtë synim, puna do të kryhet si me njësitë e vetëqeverisjes lokale ashtu edhe me komunitetet rome. Fushatat do të organizohen për të fuqizuar Romët, për të mbrojtur të drejtat e tyre për strehim, dhe do të sigurohen grante të vogla për iniciativat e reja dhe të qëndrueshme për vendbanimet që janë apo do të legalizohen.

#### 4. Lufta kundër diskriminimit dhe promovimi i vizibilitetit për komunitetet rome

Institucionalizimi i praktikave anti-diskriminuese do të promovohet në të gjithë rajonin, me një fokus në përmirësimin e hyrjes së Romëve në sistemin arsimor, atë shëndetësor dhe në sistemin e mirëqenies sociale.

Në të njëjtën kohë, projekti do të trajtojë diskriminimin publik dhe paragjykimet ndaj Romëve, duke ofruar mundësitë për mediat publike dhe gazetarët që të paraqesin një imazh të paanshëm të popullsisë Rome, nëpërmjet dokumentarëve, njoftimeve mediatike dhe trajnimeve gazetareske.

#### 5. Bashkëpunimi rajonal

Projekti do të nxisë bashkëpunimin rajonal përmes mbledhjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të ekspertëve si dhe përmes mundësive për autoritetet qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile për të shkëmbyer këndvështrimet e tyre.